

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr	Data e Kërkesës ¹	Objekti I Kërkesës ²	Data e Përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
1	29.02.2024	Kërkesë për informacion për njehsim diplome nga IAL-të	01.03.2024	Përsëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar” Une kam studiuar ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes ne degen Biznes Menaxhim dhe Administrim. Ne daten 07.02.2023 ne oren 14:44 kam bere aplikim online ne e -Albania per njehesimin e diplomes se huaj. Bazuar ne faqen zyrtare te QSHA nevojiten 45 dite per marrjen e sherbimit kur aplikimi behet online, une akoma nuk kam marr asnje informacion ne lidhje me diplomen time edhe pse kane kaluar nje vit. Do e vleresoja shume nese me jepni nje pergjigje ne lidhje me problemin tim.	E deleguar	Nuk ka
2	01.03.2024	Kërkesë për informacion për certifikatë personale	01.03.2024	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju informojmë se për të siguruar dokumentin që kërkon, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania për certifikatë personale në linkun e mëposhtëm. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=38 Në mënyrë që t`ju jemi sa më shumë në ndihmë, na kontaktoni në	E plotë	Nuk ka

¹ Data e regjistrimit të kërkesës

² Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

³ Data e kthimit të përgjigjes

⁴ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁵ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁶ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik

				numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.		
3	01.03.2024	Kërkesë për informacion për përfitim nga programi i mbrojtjes së vecantë për gratë	01.03.2024	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se për të përfituar nga programi i mbrojtjes së veçantë për gratë prind i vetëm me fëmijë, duhet të paraqiteni pranë njësisë Tuaj administrative për të plotësuar formularin që përmban kriteret e përfshirjes në skemën e ndihmës ekonomike. Në kërkesën Tuaj për informacion nuk citoni nëse jeni apo jo në marrdhënie pune, pasi në këtë skemë përfshihen personat pa të ardhura ekonomike. Në mënyrë që t`Ju jemi sa më shumë në ndihmë, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
4	03.03.2024	Kërkesë për informacion për rinovim passaporte	04.03.2024	Pershendetje, Referuar kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se duhet te blini kuponin prane Postes Shqiptare dhe me pas te paraqiteni prane zyrave Identitek per te kryer rinovimin. Duhet te keni me vete karten ID dhe passaporten e skaduar. Dite te kendshme!	E plotë	Nuk ka
5	04.03.2024	Kërkesë për informacion për pension familjar	04.03.2024	Përsëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar” Pershendetje, kam nje pyetje rreth pensionit familjar. Une kam patur pensionin e babait tim ne 2019-2020 ne kohen qe isha studente, me pas u nderpre pasi fillova pune. Kete pension ka te drejte ta marre mami tani qe mbush 55 vjec. Cilat jane fazat e aplikimit dhe dokumentet qe duhet te beje gati ajo per dorezim dhe ku? Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
6	05.03.2024	Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi	05.03.2024	Pershendetje, Lutemi kontaktoni me suportin teknik e-albania ne adresen helpdesk2@e-albania.al . Ata so ju orjentojne lidhur me gjenerimin e passwordit te adreses tuaj ne e-albania. Per pyetje te metejshme, kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka

7	06.03.2024	Kërkesë për informacion për tejkalim të afatit ligjor për lëvrimin e shërbimit	06.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se afati ligjor për te kthyer përgjigje suporti teknik i portalit e-albania është 5 dite pune. Nëse keni tejkalim të afatit ligjor të lëvrimit të shërbimit, plotësoni aktesën në portalin e bashkëqeverisjes në linkun e mëposhtëm: Brenda 10(dhjetë) ditëve do merrni përgjigje. https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
8	06.03.2024	Kërkesë për informacion për regjistrim në portalin e-albania	06.03.2024	Përshëndetje, Lutemi adresoni kërkesën tuaj për informacion pranë suportit teknik të portalit e-albania në adresën e e-mail helpdesk@e-albania.al pasi ata janë që mund t'ju ndihmojnë me procesin e hapjes së llogarisë për herë të parë si shtetas jashtë Shqipërisë. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
9	06.03.2024	Kërkesë për informacion për pension pleqërie	07.03.2024	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar” Kemi lexuar që edhe vitet e pensionit të invaliditetit të perkohshëm, mund të llogariten për pensionin e pleqërisë. Mamaja ime, ka përfituar për një periudhë disa vjetecare pas vitit 1994, edhe një pension invaliditeti. A mund të pyes nëse përmes e-albanias mund të marrim/kerkojme një vërtetim edhe për vitet e pensionit të invaliditetit pas vitit 1994 ? Në mënyrë që ta vendosim në aplikimin për pension pleqërie? Ju falenderoj nga zemra edhe nga mamaja.	E deleguar	Nuk ka
10	08.03.2024	Kërkesë për informacion për pajisje me letërnjoftim elektronik	08.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se procedura e pajisjes me letërnjoftim elektronik(kartë identiteti) është si më poshtë: - Nëse pajisja me kartë identiteti është për herë të parë, duhet të paraqiteni pranë gjendjes civile, dhe të pajiseni me vërtetim si banor i njësisë. Më pas: Blini kuponin në sportelet e postës shqiptare Paraqituni pranë Identitek pranë njësisë	E plotë	Nuk ka

				Tuaj dhe vazhdoni procedurën. Sjellim në vëmendje se kur është pajisje për herë të parë, duhet të paraqiteni vetëm në pikën IdentiTek që i korrespondon qytetit tuaj dhe njësisë Tuaj administrative. - Në rasti Tuaj, që keni rinovim te letërnjoftimit elektronik, mjafton të blini kuponin dhe te paraqiteni në çdo pikë IdentiTek me te afert. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
11	08.03.2024	Kërkesë për informacion për ndryshim vendbanimi	08.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të bërë saktësimin e vendbanimit, do logoheni me të dhënat Tuaja në e-albania dhe do të aplikoni shërbimin "Aplikim për ndryshim/Saktësim Vendbanimi" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14419 Në aplikim do ngarkoni në format PDF njërin nga dokumentet e mëposhtme që vërtetojnë pronësinë e banesës ku do jetoni: -Kopje te noteruar te certifikates se pronesise -Kontrate noteriale qeraje -Akt noterial perdorimi banese. Si edhe kartat e identitetit të secilit prej anëtarëve të familjes që do bëjnë saktësimin e adresës bashkë me Ju. Per cdo pyetje paqartesi na kontaktoni në vijim në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat , nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
12	11.03.2024	Kërkesë për informacion zyrtar të pasurisë	11.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të tërhequr lejen e legalizimit duhet të paraqiteni pranë ASHK, ose të aplikoni shërbimin informacion zyrtar të pasurisë duke hartuar një kërkesë me shkrim ku të citoni kërkesën Tuaj. Këtë kërkesë duhet ta ngarkoni në format PDF në hapin e tretë të aplikimit. Tek të dhënat e pronës vendosni zonën kadastrale të qytetit apo fshatit Tuaj ndërsa volum dhe faqe plotësojini me 9 ose 1. Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë): https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 Për	E plotë	Nuk ka

				cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
13	11.03.2024	Kërkesë për informacion për kërkesë kredie	11.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet t`i drejtoheni institucioneve kredihënëse, që janë bankat e nivelit të dytë. Ne mund T`ju informojmë lidhur me dokumentacionin shoqërues, por fillimisht duhet të paraqiteni në sportelet e bankës tek oficerët e kredisë. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
14	11.03.2024	Kërkesë për informacion për passaportë biometrike	11.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se, në rast se pasaporta aktuale është lëshuar pas datës 1 Janar 2012 duhet vetëm të blini kuponin dhe te paraqiteni tek Identitek që ndodhet pranë gjëndjes Tuaj civile pa qëne nevoja te lini takim. Afati më i shkurtër për t`u pajisur me pasaportë është brenda 72 orëve që realizohet duke paguar kuponin emergjent prej 18 mijë lekësh. Me kupon shtatëmijë e pesqin lekësh, afati i pajisjes me pasaportë është 14 ditë. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
15	11.03.2024	Kërkesë për informacion për mungesë lëvrimit shërbimi	11.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se afati për lëvrimit e shërbimit ne fjale eshte 5 dite pune. Nëse keni tejkallim të afatit ligjor të lëvrimit të shërbimit, plotësoni akeshën në portalin e bashkëqeverisjes në linkun e mëposhtëm: Brenda 10(dhjetë) ditëve do merrni përgjigje. https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim . Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka

16	11.03.2024	Kërkesë për informacion për shpallje martesë	12.03.2024	Përshëndetje, Duke ju referuar kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se dokumenti i vetëm për të kryer shpalljen e martesës është Karta e Identitetit. Pa kartë ID nuk mund të kryhet shpallja e martesës. Ju sugjerojmë të shtyni fluturimin, ose të kryeni shpalljen e martesës një moment të dytë, kur partnerja juaj të jetë pajisur me kartë ID. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
17	12.03.2024	Kërkesë për informacion për akt martesor	12.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjme me dije se dokumenti i vetëm që duhet për të regjistruar martesën në gjendjen civile në Shqipëri, është Akti i martesës me vulë apostile. Mënyra tjetër e regjistrimit të aktit të martesës është edhe online nga llogaria Juaj në e-albania nëpërmjet shërbimeve konsullore. Aplikim për regjistrim martesë. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9768 <i>Dokumentet që duhet të ngarkohen nga aplikanti:</i> - Certifikata e martesës, lëshuar nga autoritetet e huaja (e legalizuar ose pajisur me vulë apostile) - Përkthimi i certifikatës së martesës, i legalizuar ose pajisur me vulë apostile (nëse nuk e legalizoni apo apostiloni përkthimin e certifikatës, kërkohet që përkthimi në gjuhën shqipe të kryehet në konsullatë ose nëse është kryer përkthimi nga përkthyes të licensuar, duhet që konsulli të lëshojë "vërtetim përkthimi". (Tarifa e përkthimit apo vërtetimit të përkthimit është 10 euro për faqe dhe është detyrim i qytetarit aplikues) - Dokumente identifikimi, pasaportë e vlefshme udhëtimi ose letër njoftimi e bashkëshortëve. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E plotë	Nuk ka
18	12.03.2024	Kërkesë për informacion për leje legalizimi	12.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se, nëse keni lejen e legalizimit në dorë, për të pajisur objektin Tuaj me certifikatë pronësie duhet të aplikoni për të regjistruar lejen e legalizimit. Ju mund të aplikoni për këtë shërbim	E plotë	Nuk ka

				<p>online përmes platformës qeveritare e-Albania në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9444</p> <p>Kërkoni shërbimin “Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ”. Aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë dhe duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit. Në hapin e dytë shtohen automatikisht edhe këto shërbime: L1- Lëshim certifikate pronësie; I5- Lëshim kopje karteletë të pasurisë; I4- Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale. Në hapin e dytë sistemi kërkon të dhënat e pronës. Vendosni zonën Kadastrale siç e keni në lejen e legalizimit, ndërsa volumin dhe faqen plotësojini me 9 ose 99. Dokumentacioni i nevojshëm për t`u ngarkuar është shkresa përcjellëse, ose në mungesë të saj leja e legalizimit. Leja e legalizimit ose çdo dokument tjetër duhet të ngarkohet në të gjitha rubrikat e detyrueshme në hapin e tretë. Mos lini asnjë opsion pa ngarkuar dokument, edhe nëse do u duhet të ngarkoni dy herë apo më shumë të njëjtin dokument, pamvarësisht se si emërtohen dokumentet në formatin e aplikimit. Aplikimi për regjistrimin e lejes së legalizimit dhe pajisjes me certifikatë pronësie nuk penalizohet me gjobë, por kujdes! Në hapin e tretë, si datë lëshimi të dokumentit do të vendosni datën e kryerjes së aplikimit të mësipërm. Në fund klikoni opsionin “Dërgo”. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë ose postë për të kryer pagesën. Ky shërbim e ka afatin ligjor 30(tridhjetë) ditë pune. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.</p>		
19	12.03.2024	Kërkesë për informacion për regjistrim nipti	12.03.2024	<p>Përshendetje, Duke qene se kerkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni ne kanaline tone te komunikimit live chat ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al nga e Hëna në të Premte, nga ora</p>	E plotë	Nuk ka

				08:00 deri në 19:00 për tju sqaruar hap pas hapi per rastin tuaj. Keshtu mund t'ju ndihmojme ne kohe reale. Faleminderit.		
20	12.03.2024	Kërkesë për informacion për pension familjar	12.03.2024	Përshëndetje, Duke qene se kerkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni ne kanalim tone te komunikimit live chat ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për tju sqaruar hap pas hapi per rastin tuaj. Keshtu mund t'ju ndihmojme ne kohe reale. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
21	13.03.2024	Kërkesë për informacion për njehsim diplome nga IAL	13.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacionin mbi numrat e llogarisë dhe IBAN, lutemi kontaktoni me email njërën nga adresat e mëposhtme. olsi.vangjeli@qsha.gov.al krisli.mico@qsha.gov.al . aleksander.prenga@qsha.gov.al . Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
22	13.03.2024	Kërkesë për informacion për zyrtar të pasurisë	13.03.2024	Përshëndetje. Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se për të marrë një informacion mbi çështjen që shtroni, mund të aplikoni shërbimin, “Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)” përmes platformës qeveritare e-Albania, në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 . Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti, pra të parashtroni kërkesën që na keni drejtuar në email. Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana juaj dhe të skanohet. Ajo do të ngarkohet në hapin e tretë të formularit në e-Albania. Në mënyrë që t`ju jemi sa më shumë në ndihmë, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka

23	07.03.2024	Kërkesë për informacion për KEMP	13.03.2024	Përschendetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar” Përschendetje, ju lutem me beni nje zgjedhje! Kam pasur mamin me Ishemi cerebrale ,dhe ka kaluar nje pjese rreth gati nje muaj e shtruar ne spitalin Neurologjik Mentor Pertrela ne tirale. Duke qene se edhe ne letren qe ka dale nga spitali thote qe eshte tetraplegjike,kur e pyesim doktorrin qe quhet Ermir Roci,na thote qe nuk I takon kempin sepse eshte e afte,doktorri e di shume mire qe mamin e kemi marre me ambulance dhe barrela ne shpi,ju lutem te me jepni nje zgjidhje si per kempin e mamin e ashtu per si babin si shoqerues dhe kundesesh, sepse sipas ligjit: Personi që bëhet i paaftë për çdo veprimtari ekonomike dhe ka gjymtime të forta e dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin), ka të drejtë të marrë pension invaliditeti. 1. Baza ligjore: - Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Po ju bashkangjis edhe Letren qe ka marre kur ka dale nga spitali.	E deleguar	Nuk ka
24	13.03.2024	Kërkesë për informacion për certifikatë pronësie	13.03.2024	Përschendetje, Duke qene se kerkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni ne kanal in tone te komunikimit live chat ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për tju sqaruar hap pas hapi per rastin tuaj. Keshtu mund t'ju ndihmojme ne kohe reale. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
25	13.03.2024	Kërkesë për informacion për dosje legalizimi	13.03.2024	Përschendetje, Ju lutemi na kontaktoni ne kanal in tone te komunikimit live chat ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për tju sqaruar hap pas hapi per aplikimin tuaj. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka

26	13.03.2024	Kërkesë për informacion për certifikatë personale	18.03.2024	<p>Përsëritje, Referuar kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se për të marrë certifikatë personale ju duhet të aplikoni në portalin e-albania për shërbimin: Certifikatë personale (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja) :https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=38</p> <p>Shërbimi elektronik "Certifikatë personale (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja)" ju mundëson të shikoni dhe verifikoni të dhënat personale dhe të gjeneroni certifikatën personale me vulë elektronike sipas tipologjisë: • Certifikatë personale sipas të dhënave aktuale (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja), nëpërmjet së cilës mundësohet verifikimi i të dhënave personale për periudhën aktuale për të cilën kërkohen. • Certifikatë personale sipas regjistrimeve të mëparshme (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja), nëpërmjet së cilës mundësohet verifikimi i të dhënave personale të një historiku të mëparshëm sipas periudhave të mëposhtme: - Për periudhën nga viti 1974 deri në vitin 2010, “Certifikata personale sipas regjistrimeve të mëparshme” do të mundësohet nga zyra e gjendjes civile përkatëse në bashki/ njësi administrative ku aplikanti ka patur regjistrimin për periudhën e kërkuar. - Për periudhën pas vitit 2010 “Certifikata personale sipas regjistrimeve të mëparshme” do të mundësohet nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGjC) i vitit 2010. Certifikata personale gjenerohet me vulë elektronike në shqip ose në gjuhë të huaj. Gjithashtu ky shërbim mundëson gjenerimin e certifikatës personale me vulë elektronike për të gjithë anëtarët që rezultojnë në përbërjen familjare të përdoruesit. <i>Baza ligjore:</i> Bazuar në Vendimin Nr. 495, datë 13.09.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike”, Ligjin Nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për Gjendjen Civile", i ndryshuar, si dhe në Vendimin Nr. 332, datë 17.03.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e formës, elementëve përbërës, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen</p>	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	---------	--------

			<p>nga shërbimi i gjendjes civile”, të ndryshuar, ky dokument me vulë elektronike i gjeneruar përmes portalit e-Albania ka të njëjtën vlerë ligjore si dokumenti fizik me vulë të njomë. Dokumentacioni i nevojshëm Për këtë shërbim nuk nevojitet dokumentacion shoqërues. Hapat e procedurës - Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania; - Zgjidhni shërbimin "Certifikatë personale (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja)"; - Klikoni butonin "Përdor"; - Përzgjidhni tipin e certifikatës duke zgjedhur “Certifikatë personale sipas të dhënave aktuale” apo “Certifikatë personale sipas regjistrimeve të mëparshme”; - Në rastin e certifikatës personale sipas të dhënave aktuale, gjenerimi i saj bëhet në kohë reale duke klikuar butonin “Shkarko dokumentin e vulosur”. Nëse ju nevojitet certifikata në gjuhë të huaj, klikoni butonin "Shfaq certifikatën në gjuhë të huaj"; - Në rastin e certifikatës personale sipas regjistrimeve të mëparshme duhet të përzgjidhet periudha “Para vitit 2010” ose “Pas vitit 2010”, në varësi të periudhës për të cilën ju nevojitet certifikata; - Për periudhën “Para vitit 2010” duhet të plotësohet seksioni me të dhënat e kërkuara dhe në fund klikoni butonin "Dërgo"; - Pasi aplikimi të dërgohet me sukses, do të merret në shqyrtim nga zyra e gjendjes civile përkatëse dhe certifikata do të dërgohet brenda 3 (tre) ditëve pune në llogarinë tuaj në portalin qeveritar e-Albania, në rubrikën “Dokumentet e mia”; - Për periudhën “Pas vitit 2010” duhet të plotësohet data për të cilën kërkohet certifikata dhe të klikoni butonin "Shfaq certifikatën". Certifikata personale sipas regjistrimeve të mëparshme do të gjenerohet menjëherë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGjC) i vitit 2010. Për shkarkimin e certifikatës personale sipas regjistrimeve të mëparshme klikoni butonin " Shkarko dokumentin e vulosur ". - Për “Aplikim për anëtarë të familjes” në rubrikën “Anëtari i familjes” përzgjidhni anëtarin, për të cilin do të gjeneroni dokumentin “Certifikatë personale sipas të dhënave aktuale” apo “Certifikatë personale sipas regjistrimeve të mëparshme”, pas vitit 2010. Certifikatën e gjeneruar me vulë elektronike mund ta gjeni në</p>	
--	--	--	--	--

				<p>çdo kohë në seksionin "Dokumentet e mia" te hapësira juaj në portalin e-Albania. Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit “Certifikata personale sipas të dhënave aktuale” dhe “Certifikata personale sipas regjistrimeve të mëparshme”, pas vitit 2010, gjenerohet <i>menjëherë</i>. “Certifikata personale sipas regjistrimeve të mëparshme” për periudhën 1974 - 2010, lëshohet <i>brenda 3 (tre) ditëve pune</i>. Periudha e vlefshmërisë Pa afat Kostot Pa pagesa Kujdes! Në rast se nuk jeni i regjistruar si shtetas shqiptar, ju nuk mund të logoheni në portalin e-albania. Për të vijuar me logimin në e-albania duhet të keni mjet identifikimi shqiptar, Kartë Identiteti apo passaportë. Në mënyrë që t`ju jemi sa më shumë në ndihmë, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.</p>		
27	14.03.2024	Kërkesë për informacion për lidhje martesë midis një shtetasi të huaj dhe një shtetasi shqiptar	18.03.2024	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se hapi i parë i lidhjes së martesës, është shpallja e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj është si më poshtë vijon : Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> · certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; · dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martesë (vërtetim për leje lidhje martesë); · dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; · fotokopje e dokumentit të identifikimit; <p>Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: • certifikatë lindje;</p> <p>• certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”;. Nëse martesa do të lidhet në Shqipëri, pas afatit të shpalljes paraqituni në gjëndjen civile bashkë me dy dëshmitarë për të lidhur martesën. Nëse martesa do lidhet jashtë, dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>		
28	14.03.2024	Kërkesë për informacion për ndryshim/saktësim vendbanimi	18.03.2024	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije kërkesa juaj për informacion është e paqartë, pasi nuk mund të ndodhë transferimi i gjendjes civile. Megjithatë, dokumentat dhe regjistrimi juaj ndryshon nga një vend në një vend tjetër, atëherë ku ju ndryshoni vendbanimin tuaj dhe regjistrohni me vendbanimin e ri. Për të bërë saktësimin e vendbanimit, do logoheni me të dhënat Tuaja në e-albania dhe do të aplikoni shërbimin "Aplikim për ndryshim/Saktësim Vendbanimi" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14419</p> <p>Në aplikim do ngarkoni në format PDF njërin nga dokumentet e mëposhtme që vërtetojnë pronësinë e banesës ku do jetoni: -Kopje te noteruar te certifikates se pronesise -Kontrate noteriale qeraje -Akt noterial perdorimi banese. Si edhe kartat e identitetit të secilit prej anëtarëve të familjes që do bëjnë saktësimin e adresës bashkë me Ju. Per cdo pyetje paqartesi na kontaktoni në vijim në numrin pa pagesë</p>	E plotë	Nuk ka

				0800 0 118, ose online chat , nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit		
29	18.03.2024	Kërkesë për informacion për certificate trangu familjar	18.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Tringut Familjar mundësohen online në e-albania. Për këto certifikata, mund te aplikoni ne linkun si më poshtë: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=377 Certifikatë familjare (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja) Për të siguruar certifikatën e tringut familjar do zgjidhni opsionin: • Certifikatë familjare për regjistrime të mëparshme (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja), nëpërmjet së cilës mundësohet verifikimi i të dhënave familjare të një historiku të mëparshëm në shqip ose gjuhë të huaj sipas periudhave të caktuara. Më pas zgjidhni opsionin Para vitit 2010. Plotësoni të dhënat që kërkohen në formular ku përfshihet dhe viti për të cilin u duhet dokumenti. Tek komentet kenë mundesine te shkruani cdo sqarim apo detaj lidhur me dokumentin qe u nevojitet. Certifikata familjare gjenerohet me vulë elektronike në shqip. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E plotë	Nuk ka
30	18.03.2024	Kërkesë për informacion për certifikimin e profesionistëve të shëndetësisë	18.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se pë t`u informuar mbi kreditet, duhet të aplikoni shërbimin " Aplikim për statusin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë", në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14037 Fillimisht duhet të regjistroheni në këtë program duke aplikuar shërbimin " Aplikim për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë", në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14039 Pasi regjistroheni pajiseni me një kod e fjalëkalim nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0	E plotë	Nuk ka

				118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.		
31	18.03.2024	Kërkesë për informacion për informacion zyrtar të pasurisë	18.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se pasi keni vendosur të saktë zonën kadastrale, volumin dhe faqen mund të plotësoni me 9,99 ose 1. Për çdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni nga e hëna në të premte në numrin pa pagesë 0800 0118 nga ora 08.00 deri në orën 19.00. Faleminderit	E plotë	Nuk ka
32	18.03.2024	Kërkesë për informacion për certificate personale	18.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nuk ekziston një shërbim që u gjeneron një dokument në formë vërtetimi lidhur me ndryshimin e emrit. Ju mund të aplikoni një certifikatë personale për regjistrime të mëparshme dhe tek komentet referoni se kjo certifikatë u duhet me shënimin e vendimit të ndryshimit të emrit. Certifikatë personale (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja) https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=38 Në rastin e certifikatës personale sipas regjistrimeve të mëparshme duhet të përzgjidhet periudha “Para vitit 2010”, në varësi të periudhës për të cilën ju nevojitet certifikata. Për periudhën “Para vitit 2010” duhet të plotësohet seksioni me të dhënat e kërkuara dhe në fund klikoni butonin "Dërgo". Pasi aplikimi të dërgohet me sukses, do të merret në shqyrtim nga zyra e gjendjes civile përkatëse dhe certifikata do të dërgohet brenda 3 (tre) ditëve pune në llogarinë tuaj në portalin qeveritar e-Albania, në rubrikën “Dokumentet e mia”; Për çdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni nga e hëna në të premte në numrin pa pagesë 0800 0118 nga ora 08.00 deri në orën 19.00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
33	18.03.2024	Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi	18.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalekalimin, për të gjeneruar një password të ri duhet të veproni si më poshtë: Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës	E plotë	Nuk ka

				- emri i babait - vendlindja e nënës. Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Nëse emailin e keni dërguar sipas modelit të mësipërm, brenda 5(pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllkohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Faleminderit.		
34	18.03.2024	Kërkesë për informacion për shpallje martesë midis dy shtetasve shqiptarë	18.03.2024	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se fillimisht duhet të kryeni shpalljen e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptar në Republikën e Shqipërisë është si më poshtë vijon: Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:</p> <p>prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; fotokopje e dokumentit të identifikimit brenda afatit të vlefshmërisë (Kartat e identitetit me vete të dy partnerët). Për të bërë shpalljen e martesës do paraqiteni me prokurë në të dyja gjëndjet civile, edhe Juaja edhe e partnerit. Gjithsesi detajet do i merrni kur të paraqiteni pranë gjëndjes Tuaj civile për veprime të mëtejshme. Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martesë. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00. Faleminderit!</p>	E plotë	Nuk ka

35	18.03.2024	Kërkesë për informacion për Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore	18.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se për të marrë Vërtetim kontributesh me bazën e vlerësuar duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin. Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore (pas datës 01.01.2012) në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13908. Në kë dokument viti 2021 do u rezultojë pa pagë e pa siguracione, por nëse e doni në formë vërtetimi të specifikuar, hartoni një kërkesë me shkrim dhe dërgojeni pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore me postë. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
36	18.03.2024	Kërkesë për informacion për procedurat për lidhje martesë	18.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se: Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë kalendarike nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, janë të lirë të vazhdojnë me procedurat e lidhjes së martesës. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanal informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
37	18.03.2024	Kërkesë për informacion për rinovim pasaporte	18.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se, në rast se pasaporta aktuale është lëshuar pas datës 1 Janar 2012 duhet vetëm të blini kuponin dhe te paraqiteni tek Identitek që ndodhet pranë gjëndjes Tuaj civile pa qene nevoja te lini takim. Në rast se pasaporta aktuale është lëshuar para datës 1 Janar 2012 duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania formularin e komisariatit të policisë: Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13851 . Afati më i shkurtër për t'u pajisur me pasaportë është brenda 72 orëve që realizohet duke paguar kuponin emergjent prej 18 mijë lekësh. Me	E plotë	Nuk ka

				kupon 7500 lekësh, afati i pajisjes me pasaportë është 14 ditë. Në rast të aplikimit me procedurë të përshpejtuar, duhet të ngarkoni në aplikim përveç fotos në format dokument 4x5, edhe foton e kuponit emergjent 18 mijë lekësh. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
38	18.03.2024	Kërkesë për informacion për rinovim të lejes së drejtimit	18.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se lejen e drejtimit e rinovoni pasi të jeni pajisur me kartë identiteti pas deklarimit të humbjes. Mbetet në kompetencën e DPSHTRR, nëse e konsideron faktin që keni në dorë vërtetimin e policisë që keni deklaruar humbjen e ID si dhe kuponin që tregon se keni aplikuar për kartë të re identiteti, apo duhet domosdoshmërisht të keni në dorë kartën e identitetit. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
39	18.03.2024	Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi	18.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futuri) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalekalimin, për të gjeneruar një password të ri duhet të veproni si më poshtë: Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - vendlindja e nënës. Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Nëse emailin e keni dërguar sipas modelit të mësipërm, brenda 5(pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllkohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri.Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
40	18.03.2024	Kërkesë për informacion për Aplikim për herë të parë për licencë individuale	18.03.2024	Përshëndetje, Ju lutemi na kontaktoni ne kanalim tone te komunikimit live chat ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për tju sqaruar hap pas hapi per aplikimin tuaj. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka

41	19.03.2024	Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi	19.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se lidhur me problemin që parashtroni provoni të dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait -vendlindja e nënës. Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Shpjegoni se kodin kërkonte T`ju vijë vetëm me email dhe prisni përgjigjen e tyre.	E plotë	Nuk ka
42	19.03.2024	Kërkesë për informacion zyrtar të pasurisë	19.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Shëngjergjin e kap Drejtoria Rurale 1 dhe zona kadastrale 3344 Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
43	19.03.2024	Kërkesë e paplotë për informacion	19.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, lutemi na kontaktoni në kanalet tona të komunikimit online brenda orarit zyrtar të komunikimit (08.00 - 19.00), pasi kërkesa juaj është e paqartë. Nëpërmjet dialogut specialistët tanë do T`ju asistojnë e orientojnë drejt shërbimit që duhet të aplikoni. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit	E plotë	Nuk ka
44	19.03.2024	Kërkesë për informacion për rinovim pasaporte	19.03.2024	Përshëndetje, Ju informojmë se procesin për kryerjen e rinovimit të pasaportës e kanë në përgjegjësi zyrat Identitek, aty ku ju paraqiteni me kuponin në dorë së bashku me vajzën. Lutemi drejtohuni pranë zyrave Identitek për procedurën në vazhdim. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
45	19.03.2024	Kërkesë për informacion për lidhje martesë	19.03.2024	Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se shteti shqiptar nuk ka informacion për dokumentat që shteti Hollandez kërkon për lidhjen e martesave. Lutemi drejtohuni institucioneve në Hollandë për pyetje të tilla. Ditë të mbarë!	E plotë	Nuk ka
46	19.03.2024	Kërkesë për informacion për aplikim pasaportë biometrike	20.03.2024	Përshëndetje, Ju informojmë se për të përfituar kryerjen e pasaportës në mënyrë të përshpejtuar, ju duhet të aplikoni online në linkun: Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim	E plotë	Nuk ka

			<p>të pasaportës: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13851</p> <p>Dokumentacioni i nevojshëm Nëse aplikimi kryhet për ju <i>personalisht</i>: - Nevojitet ngarkimi i fotografisë në standardin 4x5cm dhe formatin jpg, jpeg ose png; - Në rast se aplikimi është emergjent - nevojitet ngarkimi i kopjes së kuponit emergjent; Nëse aplikimi kryhet nga prindi për fëmijën nën 16 vjeç: - Nevojitet ngarkimi i fotografisë në standardin 4x5cm dhe formatin jpg, jpeg ose png; - Në rast se aplikimi është emergjent - nevojitet ngarkimi i kopjes së kuponit emergjent; Nëse aplikimi kryhet për personin nën kujdestari apo me prokurë: - Nevojitet ngarkimi i fotografisë në standardin 4x5cm dhe formatin jpg, jpeg ose png; - Prokura ose vendimi gjyqësor që autorizon kryerjen e aplikimit nga një person tjetër; - Në rast se aplikimi është emergjent - nevojitet ngarkimi i kopjes së kuponit emergjent. Hapat e procedurës - Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania; - Zgjidhni shërbimin "Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës"; - Klikoni butonin "Përdor"; - Përzgjidhni tipin e aplikimit "Aplikim për veten", "Aplikim për fëmijën nën 16 vjeç" ose "Aplikim për personin nën kujdestari apo me prokurë"; - Plotësoni fushat e kërkuara në formular dhe ngarkoni dokumentacionin shoqërues të nevojshëm; - Klikoni butonin "Dërgo" për finalizimin e aplikimit; - Pas shqyrtimit të aplikimit ju do të njoftoheni me sms dhe e-mail për miratimin ose jo të procedurës së kërkuar ligjore nga Policia. - Pjesë e mesazhit të miratimit do të jetë edhe linku ku ju duhet të rezervoni datën dhe orën për t'u paraqitur fizikisht me qëllim vijimin e aplikimit. Kujdes! Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, ju duhet të keni me vete kuponin që do të duhet ta dorëzoni pranë Zyrës së IdentiTek. Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit 1 ditë për aplikim emergjent; 1-7 ditë për aplikim normal. Për çdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni nga e hëna në të premte në numrin pa pagesë 0800 0118 nga ora 08.00 deri në orën 19.00. Faleminderit.</p>	
--	--	--	---	--

47	19.03.2024	Kërkesë për informacion për aplikim passaportë biometrike	20.03.2024	Pershendetje, Ju bejme me dije se veprimet administrative per te gjithë sherbimet qe doni te merrni behen prane qytetit ku gjendeni i rregjistruar ne Gjendjen Civile. Ne rastin tuaj rinovimin e passaportes duhet ta kryeni prane zyrave Identitek Vlore. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
48	20.03.2024	Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi	20.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se lidhur me problemin që parashtroni provoni të dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - vendlindja e nënës. Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Shpjegoni se kodin kërkoni T`ju vijë vetëm me email dhe prisni përgjigjen e tyre. Faleminderit	E plotë	Nuk ka
49	20.03.2024	Kërkesë për informacion për shpallje martesë	25.03.2024	Përshëndetje, Ndonëse ju nuk keni specifikuar nëse partneri juaj është i huaj apo shqiptar, ne po ju dërgojmë procedurën për të bërë shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptar: Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesë. Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë: prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; fotokopje e dokumentit të identifikimit brenda afatit të vlefshmërisë (Kartat e identitetit me vete të dy partnerët) Për të bërë shpalljen e martesës do paraqiteni me prokurë në të dyja gjëndjet civile, edhe Juaja edhe e partnerit. Gjithsesi detajet do i merrni kur të paraqiteni pranë gjëndjes Tuaj civile për veprime të mëtejshme. Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm	E plotë	Nuk ka

				<p>pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martesë. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. Kujdes! Në rastin se bashkëshorti juaj i ardhshëm është i huaj ju bëjmë me dije se ndiqet procedurë tjetër! Për cdo pyetje tjetër, lutemi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>		
50	20.03.2024	<p>Kërkesë për informacion për vërtetim të moskryerjes së shërbimit ushtarak</p>	25.03.2024	<p>Përsëritje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju duhet të aplikoni në portalin e-albania në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14420 Vërtetim të kryerjes/moskryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv Shërbimi "Vërtetim të kryerjes/moskryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv " u mundëson qytetarëve të aplikojë online për pajisjen me vërtetim për kryerjen apo mos kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Ky shërbim ofrohet për shtetasit e Republikës së Shqipërisë për ta paraqitur në institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për arsye punë apo përfitime pensionesh të ndryshme. Dokumente që ngarkohen nga aplikanti 1. Kopje librezës ushtarake/mandat pagesë nëse disponon (e skanuar) Hapat e procedurës - Identifikohuni si qytetar në portal; - Zgjidhni shërbimin "Vërtetim të kryerjes/moskryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv"; - Klikoni butonin "Përdor"; - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme; - Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit; - Punonjësi i Qendrës së Personel Rekrutimit proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret i kthen përgjigje me e-mail aplikuesit, me URL-në e shkarkimit të përgjigjes elektronike të ruajtur tek "Dokumentet e mia" në e-Albania, ose me njoftimin e arsyes së refuzimit. Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit 10 ditë nga mbërritja në QPR. Periudha e vlefshmërisë 3 muaj Kostot Pa pagesë. Për cdo pyetje tjetër, lutemi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>	E plotë	Nuk ka

51	20.03.2024	Kërkesë për informacion për kartë shëndeti	25.03.2024	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju mund të shkarkoni kartat e shëndetit të prindërve tuaj nga llogaritë e tyre elektronike në shërbimin e mëposhtëm: Karta e Shëndetit Bashkëlidhur linku: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=7178 Për çdo pyetje tjetër, lutemi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
52	21.03.2024	Kërkesë për informacion për hapje nipti	25.03.2024	Përsëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar” Kam hasur disa shkelje, e para un si person qe ska punuar asnjeher dhe nuk figuroj ne asnje libeze pune, dhe skam perdorur as kam perfituar asnje te ardhur 0, nga varferia madhe qe kam pasur ne nentor 2013 kam hapur nje NIPT:L32301017D Adriana Kristo person fizik. Pa dijeni fare kam paguar 100 lek dhe e kam hapur pa pasur dijeni fare se ca esht dhe nuk e kam perdorur asnjeher gje qe esht e qarte te tatimet. Letren e Niptit tim e kam gjetur ne 2020 ne nje garazhd. Mua per 8 vjet nuk me erdhi kurre asnje telefonat mesazh ose lajmerim ose nje agjent i tatimeve ne adrese ne zonen time te me lajmeronte qe kam harruar nje nipt hapur pa dijenin time, autoriteti publik esht fajtor sepse ska ardhur asnjeher te me lajmeroje per kte nipt nuk e dija fare ca ishte, kerkoj nga instancat perkatese ta marrin ne konsiderate ankesen time sepse eshte e qarte qe un se kam perdorur kurre ate nipt e kam hapur nga padituria nuk e dija qe rrinte hapur as si funksiononte,dhe personi te sporteli kur e kam hapur nuk me ka njohur me rregullat se si funksionon nje NIPT. Si ka mundesi qe agjentet e tatimeve nuk jan paraqitur asnjeher per te me njoftuar. Nuk kam mundesi ekonomike te paguaj faturat te tatimeve miliona qe un nuk kam dijeni cfare jane.	E deleguar	Nuk ka

				Fajtoret fillojne qe te personi i punesuar te sporteli. Agjentet e tatimeve qe nuk erdhen asnjeher. Si ka mundesi qe me kerkohe te paguaj nje veprim qe un se kam perdorur kurre. Un jam papun dhe burrin e kam me asistence pa pune. Edhe kam 1 faturim per kte nga bashkia qe as per ate sjam ne dijeni.		
53	25.03.2024	Kërkesë për informacion për certificate nga akti i lindjes	25.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjme me dije se për të marrë certifikatë nga akti i lindjes, për aktet e regjistruara para vitit 2010, veprohet si më poshtë duke aplikuar ne linkun bashkelidhur nga llogaria Juaj e-Albania: Certifikatë nga akti i lindjes https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11176 Hapat e procedures - Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania; - Zgjidhni shërbimin "Certifikatë nga akti i lindjes"; - Klikoni butonin "Përdor"; - Përzgjidhni tipin e certifikatës për për periudhën historike duke zgjedhur "Certifikatë historike"; Në rastin e certifikatës historike duhet të përzgjidhet periudha "Para vitit 2010". Për periudhën "Para vitit 2010" duhet të plotësohet seksioni me të dhënat e kërkuara dhe në fund klikoni butonin "Dërgo"; - Pasi aplikimi të dërgohet me sukses, do të merret në shqyrtim nga zyra e gjendjes civile përkatëse dhe certifikata do të dërgohet në llogarinë tuaj në portalin qeveritar e-Albania, në rubrikën "Dokumentet e mia". Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
54	25.03.2024	Kërkesë për informacion për shpallje martesë midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj	25.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se hapi i parë i lidhjes së martesës, është shpallja e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj është si më poshtë vijon : Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar: certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që	E plotë	Nuk ka

				<p>pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; fotokopje e dokumentit të identifikimit; Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar.</p> <p>Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • certifikatë lindje; • certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”;. Nëse martesa do të lidhet në Shqipëri, pas afatit të shpalljes paraqituni në gjëndjen civile bashkë me dy dëshmitarë për të lidhur martesën. Nëse martesa do lidhet jashtë, dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! 		
55	21.03.2024	Kërkesë për informacion për shpallje martese midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj	25.03.2024	Përsëritje, Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet e mëposhtme për shpalljen e martesës (të legalizuar, përkthyer dhe noterizuar):	E plotë	Nuk ka

			<ul style="list-style-type: none"> • Certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e Gjendjes Civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; • Dokumentin / Certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); • Dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; • Fotokopje e dokumentit të identifikimit. <p>Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar.</p> <p>Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Certifikatë lindje; • Certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”. <p>Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare.</p> <p>Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e Gjendjes Civile në Shqipëri, në zyrën e Gjendjes Civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit.</p>		
--	--	--	--	--	--

56	21.03.2024	Kërkesë për informacion për Vërtetim për individ të paregjistruar	25.03.2024	<p>Përschendetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se ju duhet të aplikoni në portalin e-albania për shërbimin: Vërtetim për individ të paregjistruar Bashkëlidhur linku: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11175</p> <p>Shërbimi elektronik "Vërtetim për individ të paregjistruar" u vjen në ndihmë qytetarëve të aplikojnë online për t'u pajisur me vërtetim që nuk janë të regjistruar për qëllime tatimore. Bazuar në Ligjin Nr. 9920 , datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, çdo qytetar ka të drejtë të kërkojë vërtetim për individ të paregjistruar. Vërtetimi është personal, përfitohet pa pagesë apo tarifë shtesë dhe mund të përdoret për t'u paraqitur si dokument në Bashki, Zyrën e Punës, Ambasadë, Bankë, ISSH etj. Ky shërbim ofrohet online me vule elektronike me vlerë të plote ligjore, për çdo person të paregjistruar për qëllime tatimore. Dokumentacioni i nevojshëm Për këtë shërbim nuk kërkohet dokumentacion shoqërues. Hapat e procedurës - Identifikohuni si individ në portal; - Zgjidhni shërbimin "Vërtetim për individ të paregjistruar"; - Klikoni butonin " Përdor"; - Plotësoni formularin përkatës elektronik; - Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit; - Pas përpunimit të kërkesës për vërtetim individ i paregjistruar, ju do të njoftoheni me e-mail për plotësimin apo refuzimin e kërkesës (duke marrë njëkohësisht edhe arsyen e refuzimit); Vërtetimin e përfunduar me vule elektronike mund ta gjeni në çdo kohë në seksionin "Dokumentet e mia" te hapësira juaj në portalin e-Albania. Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit 1 ditë pune Periudha e vlefshmërisë Pa afat Kostot Pa pagesë Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>	E plotë	Nuk ka
57	21.03.2024	Kërkesë për informacion për document lidhje martese	25.03.2024	<p>Pershendetje, Ju bëjmë me dije se dokumenti certifikatës së lindjes nuk mund të zëvendësohet me dokumenta të tjera për lidhjen e martesës.</p>	E plotë	Nuk ka

				Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
58	21.03.2024	Kërkesë për informacion për ndryshim emri në gjendjen civile	25.03.2024	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar” Pershendetje,uroj qe ky e-mail t'ju gjej mire! Jam nje shtetase shqiptare qe kerkoj informacion mbi ndryshimin e emrit ne giendjen civile sipas kodit ligjor ne shqiperi pasi prej vitesh eshte bere problematik per mua. Ne zyrat e gjendjes civile te qarkut tim (Berat) japin ne forme te prere fjali te tipit " nuk lejohet ndryshimi ne asnje rast" gje qe nuk perputhet me vlerat e nje shteri qe ka synim hyrjen ne bashkimin europian. Ndryshimi i emrit eshte nje element themelor ne te drejtat e njeriut dhe ne Shqiperi shkelet haptazi. Nese jam e pa informuar rreth kesaj ceshtje,do ju lutesha te vendoseshit ne kontakt me mua nepermjet ketij maili. Per cfaredolloj detaji tjetet jam e gatshme te bashkpunoj.	E deleguar	Nuk ka
59	21.03.2024	Kërkesë për informacion për njehsim diplome nga IAL	25.03.2024	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar” Jam prej Maqedonie. dhe a mundem qe dokumentat per njesim te diplomave ti dorezoj dorazi dhe nese jo Ju lutem me tregoni ne cfare zhirollogari ta bej pagesen dhe sa leke duhet. Ju faleminderit per mirekuptimin dhe pres konfirmimin Tuaj.	E deleguar	Nuk ka

60	22.03.2024	Kërkesë për informacion për dokumentacion nga e-albania	25.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se dokumenti i shkarkuar nga e-albania është dokument zyrtar i gjeneruar nga aplikacioni qeveritar, pra është i vlefshëm. Megjithatë nëse ju kanë kërkuar përkthim nga zyrë përkthimi së bashku me vulën e akreditimit të përkthimit ju duhet të zbatoni rregullat e institucionit që ua kërkon. Faleminderit! Përshëndetje, Kam nevojë për një certifikat lindjeje në Anglisht e përkthyer nga përkthyes i akredituar (<i>Copy of your birth certificate - If this document are not in English please provide a certified English translation by an accredited translator</i>). Kam hyrë tek uebsajti e-Albania dhe e kam shkarkuar certifikatën e mëposhtme që po ju dergoj me email. Kjo certifikatë korrespond me atë të lindjes dhe e vlefshme jashtë Shqipërie sipas kërkesës në Anglisht?	E deleguar	Nuk ka
61	22.03.2024	Kërkesë për informacion për njehsim diplome nga IAL	25.03.2024	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoriteti tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezultojnë se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”Përshëndetje ju lutem për pjesën e njohjes të shkollës se lart cilat janë personat që nuk paguajnë tarifën tek e-albania? Personat që kanë dokumente grek ose italiane 2-3 vjeçare paguajnë apo jo tarifën? Pls flm.	E deleguar	Nuk ka
62	22.03.2024	Kërkesë e paplotë për informacion	25.03.2024	Përshëndetje, Lutemi dërgoni kërkesën e plotë për informacion. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
63	24.03.2024	Kërkesë për informacion për certifikatë për lidhje martesore	25.03.2024	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoriteti tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezultojnë se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar” Përshëndetje kam marrë certifikatë për lidhje martesore,po shteti Filipine kërkon një vërtetim që nuk kam qenë i martuar asë i divorcuar ku mund t'a marrë këtë????	E deleguar	Nuk ka

64	24.03.2024	Kërkesë për informacion për asistencë në procesin e aplikimit të DIVA	25.03.2024	Përshëndetje, Duke qene se kerkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni ne kanalim tone te komunikimit live chat ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për tju sqaruar hap pas hapi per rastin tuaj. Keshtu mund t'ju ndihmojme ne kohe reale. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
65	25.03.2024	Kërkesë për informacion për Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore	25.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije së për tu pajisur me vërtetim për periudhen e kontributeve mund të aplikoni online shërbimin “Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore (pas datës 01.01.2012)” nëpërmjet platformës e-albania në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13908 Klikoni butonin "Përdor" për të parë dhe shkarkuar vërtetimin për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore si i punësuar me vulë elektronike. Vërtetimin e gjeneruar me vulë elektronike mund ta gjeni në çdo kohë në seksionin "Dokumentet e mia" te hapësira juaj në portalin e-Albania. Janë shërbime pa pagesë dhe vërtetimi gjenerohet menjëherë. Në këtë formë e gjeneroni nëse keni qëndruar në Shqipëri me leje qëndrimi dhe dhe të jeni regjistruar në e-albania. Nëse jo, hartoni një kërkesë me shkrim dhe dërgojani sigurimeve shoqërore me postë. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 . Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
66	25.03.2024	Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi	25.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalekalimin, për të gjeneruar një password të ri duhet të veproni si më poshtë: Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait	E plotë	Nuk ka

				- vendlindja e nënës. Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5(pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllkohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Faleminderit		
67	25.03.2024	Kërkesë për informacion për rishqyrtim pensioni	25.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se për të rinovuar pensionin familjar, duhet të aplikoni nga llogaria juaj në e-albania shërbimin, Kërkesë për rishqyrtim përfitimi (pensioni) në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=2304 Do t`ju shfaqen opsionet e mëposhtme. Përzgjidhni opsionin "Familjar" Pleqëri Invaliditet Familjar Suplementar Suplementar i parakohshëm Pension i parakohshëm për vjetërsi shërbimi Kompesim i energjisë elektrike (VKM 565, VKM 8) Kompesim për personat në ngarkim Ngarkoni dokumentet në format pdf dhe dërgoni aplikimin. Pasi të dërgoni aplikimin, paraqituni në sportelet e Postës Shqiptare për të dërguar dokumentet origjinalë, duke vendosur mbi zarf numrin e referencës së aplikimit. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E plotë	Nuk ka
68	25.03.2024	Kërkesë për informacion për aplikim pasaporte	25.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se për të kryer aplikimin për pajisje të femijes për herë të parë me pasaportë, duhet të aplikoni nga llogaria e prindit në e-albania shërbimin: Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13851 Klikoni opsionin “Përdor” dhe plotësoni formularin “Aplikim i	E plotë	Nuk ka

				<p>formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës”. Zgjidhni opsionin "Për fëmijën" dhe vazhdoni me plotësimin e të dhënave që u kërkohen. Ju nevojitet ngarkimi i fotografisë së fëmijës në standardin 4x5cm në formatin jpg, jpeg ose png. Në rastin kur aplikimi është me procedurë të përshpejtuar (ose aplikim emergjent), nevojitet përveç ngarkimit të fotos, edhe ngarkimi i kopjes së kuponit të procedurës së përshpejtuar. Pas shqyrtimit të aplikimit do të njoftoheni me sms dhe e-mail për miratimin ose jo të procedurës ligjore të kërkuar nga Policia. Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, duhet të keni me vete kuponin dhe fëmijën. Nëse fëmija ka pasur pasaportë 5 - vjeçare dhe i ka mbaruar vlefshmëria, mjafton të bleni kuponin në postë dhe të rezervoni takimin tek Aleat. Nuk nevojitet aplikimi i formularit të policisë në e-albania. Kujdes! Emaili me të cilin jeni i regjistruar në e-albania duhet të jetë aktiv sepse atje do Ju vijë miratimi i aplikimit Tuaj dhe linku për rezervim. Lidhur me pyetjen se ku janë zyrat e Identitek, bëjmë me dije se zyrat ndodhen afër gjendjes Tuaj civile. Ndërsa për oraret, nuk ka nevojë për rezervim. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit</p>		
69	25.03.2024	Kërkesë për informacion për plan rilevimi	25.03.2024	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni për plan rilevimi për secilën parcelë veç e veç. Për çdo pyetje e paqartësi na telefononi në numrin pa pagesë 0800 0118 nga e hëna në të premte nga ora 08.00 deri në orën 19.00. Faleminderit.</p>	E plotë	Nuk ka
70	25.03.2024	Kërkesë për informacion për Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme	25.03.2024	<p>Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme: "Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme" është një shërbim elektronik, i cili u mundëson qytetarëve të kryejnë online procesin e deklarimit të humbjes së dokumenteve të ndryshme. Baza ligjore: - Ligji Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit"; - Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i</p>	E plotë	Nuk ka

			<p>ndryshuar; - Ligji Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”.</p> <p>Dokumentacioni i nevojshëm</p> <p>Dokumente që ngarkohen nga aplikanti: - Prokurë ose Vendim Gjyqësor, në rastet kur aplikohet për personin nën kujdestari apo me prokurë; Hapat e procedurës - Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania; - Zgjidhni shërbimin "Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme"; - Klikoni butonin " Përdor"; - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular; - Pas përgatitjes së vërtetimit të humbjes, ju do të njoftoheni me e-mail dhe te seksioni “Dokumentet e mia” në e-Albania. Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit 3 ditë</p> <p>Periudha e vlefshmërisë Pa afat; Kostot Pa kosto. Pas deklaramit të humbjes së dokumentit të lejes së qarkullimit, do prisni konfirmimin nga sistemi e-albania. Sapo t'ju vij konfirmimi në sistem do vijoni me procedurën e aplikimit për rinovimin e patentës pranë sporteve të DPSHTRR-së. Dokumentet që duhen me vete kur të paraqiteni në sportelin e DPSHTRR-së janë:Dokument identifikimi; Certifikatë mjekësore me fotografi, e cila vërteton aftësinë shëndetësore për të drejtuar mjetin rrugor; Lejen e drejtimit aktual që zotëron. 2. Tarifa: Rinovimi i lejes së drejtimit: 3,500 lekë.</p> <p>Për të gjitha rinovimet e lejeve të drejtimit të kategorisë B që janë me afat 3/5-vjeçar ose janë me kufizime për shkaqe shëndetësore: 2,000 lekë.</p> <p>3. Ku dhe kur tërhiqet Leja e re e Drejtimit? Leja e re e Drejtimit tërhiqet pranë sporteve të shërbimit të Drejtorive Rajonale ku është bërë aplikimi. Në Tiranë, leja e drejtimit tërhiqet për 30 minuta në zyrat e shërbimit të ish-NSHRAK. Në Drejtoritë e tjera Rajonale, kjo procedurë mund të zgjasë 3-5 ditë pune. Ju mund të gjurmoni lejen tuaj të re të drejtimit për të parë nëse është dërguar te drejtorja rajonale:https://www.dpshttr.al/gjurmim-lejedrejtimi! Kujdes! Në rast se nuk jeni i regjistruar si shtetas shqiptar, ju nuk mund të kryeni deklaramin e humbjes së patentës. Për të vijuar me logimin në e-albania duhet të keni mjet identifikimi shqiptar, Kartë Identiteti apo</p>	
--	--	--	--	--

				passaportë. Në mënyrë që t`ju jemi sa më shumë në ndihmë, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit		
71	25.03.2024	Kërkesë për informacion për rinovim passaporte	25.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse pasaporta ka skaduar pas vitit 2022, blini kuponin në postë dhe paraqituni në pikën Identitek prane gjendjes tuaj civile. Nuk ka nevojë për rezervim. Nuk ka nevojë për aplikimin e formularit të policisë në e-albania. Për çdo pyetje e paqartësi na telefononi në numrin pa pagesë 0800 0118 nga e hëna në të premte nga ora 08.00 deri në orën 19.00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
72	25.03.2024	Kërkesë për informacion për leje qëndrimi	25.03.2024	Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju informojmë se për të marrë një informacion të përgjithshëm dhe mënyrën e aplikimit mbi shërbimin " Kërkesë për leje qëndrimi " klikoni në këtë link : https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9628 . Pas konfirmimit të plotësimit të kushteve dhe dokumentacionit për të aplikuar për leje qëndrimi nëpërmjet këtij shërbimi, i huaji njoftohet nga autoritetet vendor përgjegjëse për kufirin dhe migracionin në territorin ku ai ka vendosur vendbanimin e tij të përkohshëm, për dërgimin nëpërmjet shërbimit postar, të këtyre dokumenteve: - dokumentacioni origjinal; - dy fotografi, në formatin e pasaportës me sfond të bardhe, të bëra në 6-mujorin e fundit; - mandat pagesë të tarifës së shërbimit (si dhe të masave administrative (gjobë) të vendosuar për shkelje të afatit të aplikimit për leje qëndrimi); - formularit të printuar dhe nënshkruar nga aplikanti me foton e aplkuar në të; Për të aplikuar për lejen e parë të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, plotësimi i formularit të duhur të aplikimit varet nga motivi i kërkuar i qendrimit në Shqipëri: - Bashkim Familjar me shtetas shqiptar; - Bashkim Familjar me shtetas të huaj të pajisur me leje qëndrimi të vlefshme në Shqipëri; - Studim; - Leje Unike ; - Arsye të tjera; - E Përherëshme; - E Përherëshme për raste të	E plotë	Nuk ka

				vecanta; Kërkesa on-line për leje qëndrimi pranë autoriteteve rajonale përgjegjëse për kufirin dhe migracionin, duhet të bëhet Brenda 30 ditëve pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke u siguruar që aplikanti i huaj: - Në momentin e aplikimit për leje qëndrimi është prezent në territorin e Republikës së Shqipërisë; - Ka qëndrim të rregull në territor; - Plotëson afatet dhe kriteret ligjore për tipin e lejes e qëndrimit për të cilën po aplikon sipas legjislacionit në fuqi për të huajt; - Ka të gjitha dokumentet e nevojshme, dokumentet nga vendi i origjinës të përkthyer dhe legalizuara; - Ka një adresë personale e-mail nëpërmjet së cilës do të kryhet komunikimi on-line me Autoritetin për Kufirin dhe Migracionin (vendosja gabim e adresës e-mail ose përdorimi i adresave e-mail të personave të tjerë, shkakton moskomunikimin e informacioneve të rëndësishme dhe shkeljen e afateve, të cilat çojnë në refuzimin e aplikimit për leje qëndrimi). Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
73	25.03.2024	Kërkesë për informacion për regjistrim në e-albania	25.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se regjistrimi në portalin qeveritar e-Albania mund të kryhet si për shtetasit shqiptarë, ashtu dhe për shtetasit e huaj të pajisur me leje qëndrimi në Shqipëri. Shtetasit shqiptarë regjistrohen nëpërmjet Numrit Personal të Identifikimit, të cilin e gjejnë në kartën e tyre të identitetit. Vendosni saktë datën e skadencës së kartës së identitetit. Nëse viti i skadencës është 2071 ose 2072 vendoseni 2031, 2032. Pasi të jetë hapur portali www.e-albania.al duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm: a. Klikoni "Regjistrohu/Register" b. Plotësoni të gjitha të dhënat e specifikuar në formularin e regjistrimit c. Kodi i përdoruesit (NID: Numri personal i identifikimit) / User Personal Identification Number (NID) : Është numri personal i identifikimit. d. Data e skadimit të kartës së identitetit / Identification document expiry date: Vendosni datën e skadimit të kartës së identitetit në formatin datë.muaj.vit.	E plotë	Nuk ka

				<p>e. Fjalëkalimi / Password: Sigurohuni që fjalëkalimi të jetë 8 deri në 12 karaktere i gjatë dhe nuk duhet të fillojë ose mbarojë me hapësira.</p> <p>f. E-mail: Në këtë adresë do të vijë linku i aktivizimit të llogarisë dhe të gjitha njoftimet që kanë të bëjnë me aplikimet tuaja.</p> <p>g. Numri i celularit / Mobile phone number: Sigurohuni që të vendoset në formatin e duhur. Për numrat shqiptarë formati është '06xxxxxxxx' ndersa për numrat jashtë Shqipërisë, formati i saktë është '0044/0039/0032xxxxxxxx', në varësi të shtetit ku jetoni.</p> <p>h. Të dhënat personale (Emri / Name, Mbiemri / Surname, Atësia / Father Name, Mëmësia / Mother Name, Datëlindja / Birthdate): Duhet të bëhet kujdes që të gjitha të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhen më të dhënat e Regjistrimit të Gjendjes Civile. <i>i. *</i> <i>Kujdes me të dhënat që mund të kenë "ë", ose "ç".j.</i> Nëse edhe pas verifikimit të të dhënave tuaja në Gjendjen Civile do të keni vështirësi me regjistrimin kontaktoni ne adresën : helpdesk@e-albania.al.</p> <p>k. Plotësoni kodin katër shifror të dërguar me SMS në numrin tuaj të telefonit dhe klikoni në linkun e aktivizimit në adresën tuaj e-mail për aktivizimin e llogarisë tuaj. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>		
74	25.03.2024	Kërkesë e paplotë për informacion	25.03.2024	Përsëritet, Ju bëjmë me dije se aplikimet për shërbimet online kryhet përmes portalit qeveritar e-albania. Lutemi na informoni qartë për llojin e aplikimit që doni të kryeni që tju vijmë në ndihmë, pasi kërkesa juaj është e paqartë! Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
75	25.03.2024	Kërkesë për informacion për shallje martesë	26.03.2024	Përsëritet, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se, data e celebrimit mund të caktohet 10 ditë pasi është kryer shpallja e martesës. Që do të thotë në rastin më të keq, ju mirë është të kryeni shpalljen e martesës rreth 20 ditë përpara, të prisni të mbushet afati kohor prej 10 ditësh e më pas të paraqiteni për të caktuar ditën e celebrimit. Megjithatë merrni parasysh që mbase ajo datë mund të jetë edhe e zënë, ndaj ju këshillojmë shpalljen e	E plotë	Nuk ka

				martesës ta bëni sa më herët aq më mirë, dhe më pas keni afat kohor 1 vit për të caktuar ditën e celebrimit tuaj. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
76	26.03.2024	Kërkesë për informacion për passaportë biometrike	26.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se: Në rast se pasaporta aktuale është brenda afatit të vlefshmërisë, duhet vetëm të blini kuponin dhe te paraqiteni tek IdentiTek pa qene nevoja te lini takim. Bashkë me kuponin duhet të keni me vete pasaportën aktuale të dëmtuar. Specialistët e IdentiTek janë ata që përcaktojnë vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e dokumentit. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
77	26.03.2024	Kërkesë për informacion për licencë projektimi	26.03.2024	Përshëndetje, Duke qene se kerkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni ne kanalin tone te komunikimit live chat ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për tju sqaruar hap pas hapi per rastin tuaj. Keshtu mund t'ju ndihmojme ne kohe reale. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
78	26.03.2024	Kërkesë për informacion për lidhje martese	26.03.2024	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se: Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë kalendarike nga e nesërmja e shpalljes. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, jeni të lirë të vazhdoni me procedurat e lidhjes së martesës. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. Shpallja e martesës si akt e ka vlefshmërinë 365 ditë kalendarike, që do të thotë se ju nuk mund të lidhni martesën më herët se 10 ditë pas shpalljes së saj, por nuk do të thotë që duhet patjetër të lidhni martesën në ditën e 11 të saj. Për çdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118,	E plotë	Nuk ka

				ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashën orare 08.00 – 19.00. Faleminderit!		
79	27.03.2024	Kërkesë për informacion për mingesë lëvrimi shërbimi	27.03.2024	<p>Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se, për çdo ankesë lidhur me mosrespektimin e afatit ligjor të lëvrimit të shërbimit, lutemi depozitoni ankesën tuaj në portalin Me ty për Shqipërinë që duam në linkun e mëposhtëm.</p> <p>https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim</p> <p>Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e komunikimit (online chat); nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p>	E plotë	Nuk ka
80	27.03.2024	Kërkesë për informacion për procure për lidhje martese	28.03.2024	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se, ju dhe partneri juaj mund të lëshoni një prokurë të posacme, që dikush tjetër të kryej procedurat e shpalljes së martesës për ju. Personi i autorizuar duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme për shpalljen e martesës (të legalizuar, përkthyer dhe noterizuar):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e Gjendjes Civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; • Dokumentin / Certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); • Dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; • Fotokopje e dokumentit të identifikimit. 	E plotë	Nuk ka

				<p>Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar.</p> <p>Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Certifikatë lindje; • Certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”. <p>Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare.</p> <p>Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e Gjendjes Civile në Shqipëri, në zyrën e Gjendjes Civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit.</p> <p>Kujdes! Vetëm shpallja e martesës mund të kryhet me prokurë të posacme! Për celebrimin duhet të jeni të dy prezentë fizikisht!</p> <p>Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e komunikimit (online chat); nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p>		
81	28.03.2024	Kërkesë për informacion për njehsim i diplomës nga IAL	28.03.2024	<p>Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion ju bejme me dije se per te njehsuar diplomen angleze ne shtetin shqiptar, ju duhet ta noterizoni dhe perktheni ne gjuhen shqipe diplomen tuaj prane nje noteri ne Shqiperi. Ju duhet te aplikoni ne sherbimin: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853 Njësimi i diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja</p>	E plotë	Nuk ka

				të arsimit të lartë ,Lexoni me kujdes udhezimet per llojin e diplomes dhe hapat e procedures per procesin e njehsimit, si dhe depozitoni dokumentacionin sipas udhezimeve. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, OSE NE LIVE CHAT ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ . Faleminderit!		
82	28.03.2024	Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi	28.03.2024	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalekalimin, për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - vendlindja e nënës. Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5(pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllkohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri.Faleminderit.	E plotë	Nuk ka